



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

RR E G U L L O R E
E PUNËS SË KUVENDIT KOMUNAL DHE ORGANEVE TË TIJ

Dragash, 21.07.2010

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/2008) , nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit, dhe vërejtjeve e plotësimeve të dhëna në seancën e Kuvendit Komunal të Dragashit të dt.21.07.2010,miratohet kjo: :

R R E G U L L O R E

E PUNËS SË KUVENDIT KOMUNAL DRAGASH DHE ORGANEVE TË TIJ

I. Rregullat e përgjithshme

1. Me këtë Rregullore përcaktohet puna e funksionimit të seancave(mbledhjeve) të KK-së Dragash dhe organeve të tijë(komiteteve,komisioneve etj.),si dhe procedura e konvokimit,diskutimit,e drejta e votimit dhe mënyrat për funksionimin normal të tyre
2. Kuvendi dhe organet e tij do të shqyrtojnë vetëm ato çështje të cilat i përkasin fushveprimit të tij,pos nëse ato ndryshshohen me kërkesën e Organeve Qendrore.
3. Çdo anëtar i cili merr pjesë në takimet-mbledhjet e organit komunal, nënshkruhen në listën e të pranishmëve të dizajnuar për këtë çështje e që shërben edhe si bazë për kompenzimin material të tyre ,sipas Rregullores së miratuar për këtë çështje.

II. Mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonëshme të Kuvendit Komunal dhe organeve të tij

4. Kuvendi Komunal,mbledhjet e rregullta i mbajnë siç është përcaktuar me nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenin 36 të Statutit të Komunës.
5. Mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonëshme të Kuvendit dhe organeve të tij, me rendin e ditës, caktohen nga kryesuesi i Kuvendit dhe kryesuesit e organeve të Komunës,në marrveshje me kryetarin e Komunës.Në mungesë të tyre, ato caktohen nga zëvendësit ,në marrveshje me kryetarin,përkatësisht nënkryetarin/ët e Kuvendit Komunal ,të autorizuar nga kryetari i Komunës.
6. Mbledhjet e jashtëzakonëshme thirren sipas nevojës së arsyeshme nga kryesuesi i KK-së, ose me kërkesën me shkrim të s'paku 1/3 së anëtarëve të Kuvendit Komunalë,organeve të tij dhe kryetarit të komunës, dhe atë, s'paku, 3 ditë pune para mbajtjes së tyre.Rendi i parapar i ditës për mbledhjen e jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohet.
7. Takimet e Kuvendit Komunal dhe organeve të tij janë të hapura për publikun, pos nëse nuk vendoset ndryshe nga anëtarët e këtyre organeve komunale.

8. Njoftimet paraprake me shkrim, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal dhe organave të tij, bëhen 7 ditë pune para mbajtjes së tyre dhe duhet të përmbajnë:

- a) datën e mbajtjes së mbledhjes,
- b) kohën e mbajtjes së mbledhjes,
- c) vendin e mbajtjes së mbledhjes.,
- d) rendin e ditës me materialet shtesë të mbledhjes(nëse ka),

9. Njoftimi u dërgohet edhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe mediave elektronike të cilat kanë kontrata me KK-në, për përcjelljen e punës së organeve komunale.

10. Për paraqitjen e propozimeve ,apo arsyetimeve nga ana e përfaqësuesëve të opinionit në mbledhje vendos kryesuesi i mbledhjes i cili ka edhe të drejtën e ndërprerjes së diskutimit.

11. Për mbledhjet e Kuvendit dhe organet e tij mbahet procesverbali (i cili përmban esencën e diskutimit dhe votimin),ndërsa miratohet në mbledhjen e radhës ,në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

III. Rregullat e diskutimit

12. Ecuria e mbledhjes vazhdon sipas rendit paraprak të ditës,pos, nëse para aprovimit të tij, vendoset ndryshe nga delegatët ,me shumicë votash.

13. Për marrjen e fjalës, në mënyrë të barabartë dhe sipas radhës së paraqitjes, vendos kryesuesi i mbledhjes, kurse diskutimet zgjasin deri në 10 minuta, me përjashtim të referuesëve dhe kryetarit të KK-së.Sqarimet apo replikat eventuale(për të cilat vendos kryesuesi) nuk mund të zgjasin më shumë se 2 minuta.Askush nuk ka të drejtë diskutimi,më tepër se një herë,për të njejtën çështje.

14. Subjektet politike caktojnë udhëheqësit e grupit të tyre, që japin propozime në emër të subjektit që e përfaqësojnë,përfshi edhe të drejtën e kërimit të pauzës konsultuese ,për të cilën përcaktohet kryesuesi i mbledhjes.

IV. Kuorumi dhe votimi

15 Para fillimit të çdo mbledhjeje (përmes listës përkatëse) duhet të konstatohet kuorumi, që është gjysëma e numrit të anëtarëve prezent, nga numri i tërësishëm i Kuvendit Komunal dhe organeve të tij..

16. Votimi, në të gjitha mbledhjet bëhet me vota të hapta, pos për rastet kur me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statut kërkohet votimi fshehtë. Para votimit për vendimin e marr, nga kryesuesi, konstatohet kuorumi dhe numri i votave, pas votimit.

17. Çdo anëtar i Kuvendit dhe i organeve të tij ka një votë, por kryesuesi ka një votë shtesë, nëse votimi është i barabartë, për ose kundër një propozimi. Abstenimi i ndonjë anëtari regjistrohet, por nuk merret parasysh në rezultatet e votimit.

V. Konflikti i interesave dhe sjelljet jo të mira të anëtarëve dhe publikut

18. Nëse për ndonjë çështje ka supozime të bazuara apo të verifikuara të konfliktit të interesit të ndonjë anëtari të Kuvendit Komunal, organit të tij, referuesit, nga kryesuesi kërkohet përjashtimi i tij/saj nga diskutimi dhe votimi.

19. Nëse kryesuesi i mbledhjes konsideron se ndonjeri nga anëtarët ka sjellje jo të mirë në mbledhje, duke mos u respektuar, qëllimisht, rjedha dhe puna e mbledhjes, në mënyrë ofenduese apo mënyrë tjetër të papranueshme, atij/asaj duhet t'i tërhiqet vërejtja. Nëse edhe pas vërejtjes së dhënë vazhdon me sjelljen e till, nga kryesuesi propozohet që mos të dëgjohet nga anëtarët tjerë dhe nëse edhe pas kësaj vazhdon me sjellje jo të mirë, anëtarit të till i ndalohej fjalimi, përfëshi edhe kërkimin që të tërhiqet-largohet nga mbledhja, përveç kur është në pyetje votimi. Masa e fundit për evitimin e sjelljeve jo të mira në mbledhje është ndërprerja e përkohëshme e mbledhjes, me caktimin e orës apo datës së vazhdimit të saj. Për sjelljet jo të mira, e njehta procedurë vlen edhe për pjesëmarrësit e publikuit në takimet e Kuvendit apo organeve të tij.

01 Nr.06-52/2
Dt.21.07.2010
D r a g a s h

KUVENDI KOMUNAL DRAGASH

Kryesuesi
Lulzim Rifaj

